



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 662/5 Prot

Tiranë, më 29.07.2016

VENDIM

Nr. 50 ,datë 29.07.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 146 datë 07.06.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës", me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri, nga kontrolluesi "Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës" gjatë kryerjes së veprimtarisë të tij në fushën e arsimit.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrit nr. 146 datë 07.06.2016 të Komisionerit "Për kryerjen e hetimit administrativ" që do të ushtrohej pranë këtij kontrolluesi.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi nuk ka një rregullore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit".
3. Kontrolluesi nuk aplikon kontrata individuale me punëmarrësit.
4. Konstatohet se në kartelat/dosjet personale të punëmarrësve ndodhen të dhëna dhe përshkrime në një afat mbi 30-vjeçar të cilat kanë të bëjnë me opinione dhe përshkrime ideologjike për subjektin e të dhënave.
5. Konstatohet se nga verifikimi i bërë pranë psikologëve në shkolla të ndryshme, dosjet me të dhëna personale të Personave me Aftësi të Kufizuara të krijuara nga psikologët e shkollave 9-vjeçare mbahen ose shkatërrohen mbas mbarimit të shkollës nga këta individë. Psikologët e gjimnazeve krijojnë dosje të reja dhe i shkatërrojnë ose jua kthejnë prindërve këto dosje mbas mbarimit të shkollës nga këta Persona me Aftësi të

Kufizuara. Konstatohet se nuk ka parashikime ligjore në lidhje me kohën e ruajtjes së dosjeve të Personave me Aftësi të Kufizuara.

6. Konstatohet se në portalin e kontrolluesit www.darkukes.arsimi.gov.al janë publikuar rezultatet e testimit të mësuesve nëpërmjet një tablele, e cila përmban ID të Aplikantit, pikët, nr. personal (ID unike) e subjektit të të dhënave, gjinia, lënda etj.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Për shkeljet e konstatuara, është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, datë 15.06.2016, në të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit nuk ka paraqitur pretendime.

Në cilësinë e provës materiale, procesverbalit i janë bashkëngjitur dokumentet e mëposhtme:

- Rregullore e brendshme e sektorit të IT dhe Statistikës, pjesë e rregullores së përgjithshme të D.A.R. Kukës;
- Tabela e publikimit të provimeve të ciklit 9-vjeçar D.A.R.-Kukës;
- Printim nga portali www.darkukes.arsimi.gov.al i tabelës së të dhënave të mësuesve që kanë aplikuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- Udhëzimi nr. 12 datë 27/04/2015 i M.A.S;
- Udhëzim nr. 38 datë 06/10/2015 i M.A.S;
- Udhëzime dhe manuale për psikologët e shkollave;
- Praktikë e psikologut të shkollave në lidhje me Personat me Aftësi të Kufizuara.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ pranë kontrolluesit, udhëzimeve 12/2015, 38/2015, 40/2015 të MAS, akteve nënligjore të miratuara nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe pretendimeve të kontrolluesit, u konkludua se:

1. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ nga inspektorët e K.D.I.M.D.P. së, është konstatuar se kontrolluesi nuk dispononte “Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale”,
Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 27 të ligjit për arsye se ai nuk ka hartuar rregullore specifike për “Mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale”, ku një detyrim i tillë është në përmbushje të Vendimit nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për “Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” dhe pikës 19, kreu “I” të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S. në të cilin është parashikuar gjithashtu hartimi i rregullores së brendshme të institucioneve arsimore për të dhënat personale të subjekteve.
2. Kontrolluesi aplikon për punëmarrësit e D.A.R. Kukës “Deklaratën e Konfidencialitetit”, por jo për të gjithë punëmarrësit/mësuesit/psikologët e shkollave. Nënshkrimi i “Deklaratës së Konfidencialitetit” me të gjithë punëmarrësit është një detyrim ligjor i cili është parashikuar në nenin 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008

"Për Mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Vendimin nr. 6 të Komisionerit datë 05.08.2013 për *"Përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"* si dhe në pikën 19, kreu "I" të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S. Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 28 të ligjit duke mos hartuar dhe nënshkruar Deklaratën e Konfidencialitetit me të gjithë punëmarrësit e tij.

3. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ, është konstatuar nga inspektorët e K.D.I.M.D.P. së se në kartelat/dosjet personale të punëmarrësve ndodhen të dhëna dhe përshkrime në një afat mbi 30-vjeçar të cilat nuk janë në përputhje me qëllimin e përpunimit të të dhënave (rekrutim). Të dhënat e tepërta konsistojnë në të dhëna sensitive mbi bindjet politike të tyre (formati deklarues është i njëjtë në të gjitha rastet për këtë kategori punëmarrësish që janë punësuar në D.A.R. para viteve 90"). Udhëzimi nr.12 datë 27.04.2015 i M.A.S., paragrafi 6, germa "c", shprehet:

"Ndër të dhënat personale të subjekteve, nuk përfshihen këto të dhëna për ta dhe prindërit/fëmijët e tyre: Origjina racore, origjina etnike, mendimet politike, anëtarësimi... etj."

Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të neneve 5, 6 dhe 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008. *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S.

4. Në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ, është konstatuar nga inspektorët e K.D.I.M.D.P. së se dosjet personale të krijuara nga psikologët e gjimnazeve ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga shkëputja e subjektit të të dhënave *"nxënës"*. Psikologët dhe punonjësit social, krijojnë dosje me përshkrime respektive edhe për nxënës të cilët mund të jenë problematik dhe krijojnë incidente sociale etj. Konstatohet se nuk ka parashikime ligjore në lidhje me përhapjen, kohën e ruajtjes dhe shkatërrimin e dosjeve të Personave me Afërsi të Kufizuara apo për personat me probleme sociale, mbas mbarimit të qëllimit të përpunimit.

Referuar nenit 5, 6, 7 dhe 27 të Ligjit nr. 9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, Udhëzimit nr. 4/2010 për *"Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit"*, pikat 18 dhe 19 të Udhëzimit nr. 12/2015 të M.A.S., është përgjegjësi e kontrolluesit marrja e masave teknike dhe organizative për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, transmetimin, shkatërrimin etj. të të dhënave personale.

Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të neneve 5, 6 dhe 27 të ligjit për arsye se nuk ka marrë masa të përshtatshme në lidhje me kohën e ruajtjes, transmetimin dhe shkatërrimin e të dhënave që përmbajnë dosjet personale të subjekteve *"nxënës"*, të krijuara nga psikologët e shkollave, në përfundim të qëllimit të përpunimit.

5. Në portalin e kontrolluesit www.darkukes.arsimi.gov.al janë publikuar rezultatet e testimit të mësuesve në format tabelar. Konstatohet se një prej tabelave të publikuara përmban listën përfundimtare e portalit për pikët e testimit të mësuesve, ID në e testimit, pikët, nr. personal (ID unike) e subjektit të të dhënave, lënda etj.

Në Udhëzimet e miratuara nga M.A.S.:

- ✓ Pika 5, Kreu II të Udhëzimit nr. 38 datë 06/10/2015 të M.A.S. - "... Renditja bëhet publike nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë arsimore vendore, ku kandidatët identifikohen me kod personal.";
- ✓ Nenit 6 "Vlerat udhëheqëse dhe karakteristikat e procesit të testimit" të Udhëzimit nr. 40/2015 të M.A.S. – "Procesi i testimit udhëhiqet nga parimet dhe vlerat e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë... a) ruajtja e fshehtësisë së testeve...";
- ✓ Nenit 9 "Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kombëtare të Provimeve" të Udhëzimit nr. 40/2015 të M.A.S. – AKP prodhon barkode për sekretimin e testeve sipas numrit të pjesëmarrësve të paraqitur nga LZh.A.;
- ✓ Nenit 10 "Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë arsimore vendore" të Udhëzimit nr. 40/2015 të M.A.S. – "h) publikon renditjen e kandidatëve sipas profileve (me ID përkatëse) për njësitë arsimore përkatëse".

kërkohej ruajtja e fshehtësisë së testeve si dhe përcaktohet publikimi i të dhënave të cilat nuk cenojnë privatësinë e subjektit të të dhënave "mësues" por mundësojnë identifikimin e tij nëpërmjet barkodit të testit të provimit dhe ID së aplikantit/mësuesit pranë DAR/ZA përkatëse. Publikimi i të dhënës "numër personal identifikimi" në këtë portal, cenon privatësinë e subjektit të të dhënave për arsye se ekspozon një të dhënë unike të tij dhe që për më tepër, nuk është në përputhje me udhëzimet e M.A.S. Sa më sipër, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 27 të ligjit për arsye se ka shkelur rregullat dhe udhëzimet në lidhje me publikimin e të dhënave të subjekteve "mësues" në portalin zyrtar www.dardukes.arsimi.gov.al.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", më datë 19.07.2016 është organizuar scanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimin e grupit të kontrollit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti pretendimet e mëposhtme:

- 1) Për sa i përket Rregullores në lidhje me "Mbrojtjen e të Dhënave Personale", e kemi pjesë të rregullores së brendshme të DAR-it, megjithatë menjëherë pas konstatimit nga ana juaj bëmë rregulloren e veçantë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale";
- 2) Për Deklaratën e Konfidencialitetit, është dërguar shkresa në të gjitha shkollat për zbatimin e Udhëzimit nr. 12/2015 të MAS. Menjëherë mbas konstatimit nga ana juaj bëmë verifikimin në disa shkolla mbi shkallën e zbatimit të këtij udhëzimi ku rezultoi se disa nga shkollat kishin nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit për punonjësit arsimorë. Për zbatimin me përpikmëri nga të gjitha institucionet e shkollave të rrethit, iu dërgua edhe njëherë të gjitha shkollave shkresa me objekt "Kujtesë mbi nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit" dhe deri tani çdo punonjës i arsimit të DAR-it e ka bërë nënshkrimin e Deklaratës së Konfidencialitetit.;
- 3) Marrëdhënia e punës ndërmjet punëdhënësit që është drejtuesi i institucionit arsimor dhe punëmarrësit që është mësuesi, është rregulluar me Vendim për emërim të përkohshëm dhe Vendim me emërim të përhershëm. Në rastet e zgjidhjes së

marrëdhënies së punës nga punonjësit arsimorë janë respektuar procedurat sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Për vitin shkollor 2016-2017 është dërguar shkresa në të gjitha shkollat me nr. 935/1, datë 21.06.2016 me objekt *"Mbi nënshkrimin e kontratës individuale të punës ndërmjet mësuesit dhe drejtorit të institucionit arsimor."*

- 4) Kartelat/dosjet personale të punëmarrësve të institucionit tonë që kanë të dhëna dhe përshkrime në një afat mbi 30 vjeçar, janë administruar sipas ligjit nr. 9154 *"Për Arkivat"*. Pas konstatimit nga ana juaj, DAR-i i është drejtuar MAS për të na dhënë ndihmën e duhur në këtë drejtim.
- 5) Në Udhëzimin nr. 12/2015 të MAS pika 15/c. nuk përcaktohet koha e ruajtjes së dosjeve me të dhënat personale të personave me aftësi të kufizuara të krijuara nga psikologët e shkollave prandaj psikologët ua kanë dhënë prindërve të fëmijëve me AK, por nuk kanë mbajtur procesverbal të nënshkruar nga prindi i nxënësit dhe psikologu i shkollës. Pas konstatimit tuaj u morën masa nga personi përgjegjës për psikologët e shkollave në DAR që për dorëzimin e dosjeve me të dhënat personale të personave me AK të krijuara nga psikologët e shkollave të mbahet *"Procesverbal"* i nënshkruar nga prindi i nxënësit dhe psikologu i shkollës.
- 6) Rezultatet e testimit të mësuesve në portalin e DAR-it janë publikuar në zbatim të:
 - Udhëzimit nr. 40/2015 të MAS *"Për organizimin e testimit të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar"* nenit 10 *"Detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë arsimore vendore"*, pika h) *"Publikon renditjen e kandidatëve sipas profileve (me ID-në përkatëse), për njësinë arsimore vendore"*.
 - E-maileve të MAS drejtuar DAR-it me datë 10.02.2016 me subjekt *"Publikimi i renditjeve të kandidatëve Mësues për Shqipërinë"*.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika "1", shkronja "dh" e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, përbëjnë *"kundërvajtje administrative"* dhe sanksionohen me gjobë.

– *"dh) Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë."*

Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën "1" të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se shkeljet e mësipërme konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cenimin e sigurisë së të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave *"mësues"* dhe *"nxënës"*.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 39/1 shkronja "dh" dhe 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, me gjobë në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, me gjobë në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, të realizojë përditësimin e dosjeve personale të punëmarrësve sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 12/2015, Udhëzimit 38/2015 të M.A.S. dhe në përputhje me nenet 5 dhe 6 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.
4. Kontrolluesi Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, në përputhje me nenin 5, gërma "c" të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të mos publikojë "numrin personal të identitetit" (ID personale) të mësuesit aplikant.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 29.07.2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI